

TEKSTE NGA SELEFI QË TREGOJNË PËR NJË KONSENSUS TË PADYSHIMTË, I CILI VËRTETON EPËRSINË [ULUWW] E ALLAHUT MBI KRIJESAT E TIJ ME QENIEN E TIJ

Për shkak të shumësisë së tekstit të selefinit nga sahabët, nga tabi'inët dhe nga ata mbas tyre, disa nga të cilat janë përmendur më herët, desha të transmetoj disa tekste të cilat bartin konsensusin e besueshëm, që vërteton epërsinë e Allahut në kuptimin e vërtetë, çka domethënë se Allahu është mbi krijesat e tij me qenien e Tij dhe me *uluww* e Tij. Kurr gjë nga çështjet e pasardhësve të Ademit s'është e fshehur nga Ai dhe ky është animi natyror [*fitra*] që Allahu e ka bërë të natyrshme për krijesat.

Imami i Shamit, AbduRrahman bin Amr ebu Amru el-Auza'i [v.157H/774 e.s.]

Ai ka thënë:

“Tabi'inët dhe vetë ne gjithmonë thoshim: Allahu është mbi Arshin e Tij dhe besojmë në çka është transmetuar në Sunet lidhur me cilësitë e Tij”⁶³.

Se'id bin Amr ed-Deb'i ebu Muhamed el-Basri [v.208H/823 e.s.]

Xhehmitë i qenë përmendur atij dhe ai tha:

“Ata kanë thënie më të këqija sesa ato të çifutëve dhe të krishterëve! Se çifutët, të krishterët dhe pjesëtarët e feve tjera pajtohen me muslimanët se Allahu është mbi Arshin e Tij ndërsa Xhehmitë thonë: 'Ai s'është mbi ndonjë gjë'”⁶⁴.

Imam el-Hafidh ibn Raheuejh Is'hak bin Ibrahim el-Hendhelij [v.238H/852 e.s.]

Edh-Dhehebi ka thënë:

⁶³ Transmetuar nga el-Bejheki në *el-Esma ue-Sifat* [Beirut: *Dar ul-Kutub el-Ilmijeh*], f.515.

⁶⁴ Shejhul-Islam ibn Tejmije ka transmetuar në *Mexhmu el-Fetaua*, vëll.5, f.52. Po ashtu, në *Dar et-Te'arud*, vëll.2, f.261. I është atribuar Ibn Ebi Hatim në *er-Redd alel-Xhehmije* dhe, gjithashtu, është transmetuar nga edh-Dhehebi në *el-Uluww*, f.158.

“Ebu Bekr el-Khellal ka thënë: el-Meruedhij na ka informuar: Muhamed bin es-Sebah en-Nejseburij na ka treguar: Ebu Daud el-Kheffef Sulejman bin Daud na ka treguar duke thënë: Is’hak bin Raheuejeh ka thënë: Allahu ka thënë:

« **Më i mëshirshmi i vendosur mbi Fronin** » [Ta-Ha, 5]

Dijetarët janë pajtuar [*ixhma*] se Allahu është i vendosur mbi Arshin e Tij dhe di gjithçka për më të ulëtën nga shtatë tokët”.

Edh-Dhehebi ka thënë:

“Dëgjoni këtë Imam sesi transmeton për *ixhma* në këtë çështje, siç ka bërë Kutejbeh gjatë kohës së Tij”⁶⁵.

Kutejbeh bin Se’id bin Xhemil bin Terif eth-Thekefi [v.240H/854 e.s.]

Edh-Dhehebi ka thënë:

“Ebu Ahmed el-Hakim dhe Ebu Bekr en-Nekash el-Mufessir ka thënë: Ebul-Abbas es-Serraxh na ka treguar duke thënë: Kam dëgjuar Kutejbeh bin Se’id të thotë: Thënia e Imamëve të Islamit, Sunetit dhe xhematit është: ‘E dimë që Zoti ynë është mbi shtatë qiejt, mbi Arshin e Tij, siç ka thënë Ai:

« **Më i mëshirshmi i vendosur mbi Fronin** » [Ta-Ha, 5]

Edh-Dhehebi ka thënë:

“Dhe njëllonj ka transmetuar Musa ibn Harun nga Kutejbeh: ‘E dimë që Zoti ynë është mbi shtatë qiejt, mbi Arshin e Tij’. Pra, Kutejbeh, si udhëheqës dhe i besueshëm që ishte, ka transmetuar se ka *ixhma* në këtë çështje, dhe ai kishte takuar Malik, el-Lejth, Hammad bin Zejd dhe të tjerët nga të mëdhenjtë. Ai, po ashtu, kishte jetuar një jetë të gjatë dhe hafidhët mblidheshin te dyert e tij. Njëherë e një kohë, a i kishte thënë një njeriut: ‘Rri te ne këtij dimri, derisa t’jua çoj pesë njerëz me njëqind mijë hadithe’”⁶⁶.

Ebu Zur’eh er-Razij Ubejdullah bin AbdulKerim el-Kureshi el-Mekhzumij [v.264H] dhe el-Hafidh ebu Hatim er-Razij Muhamed bin Idris bin el-Mundhir el-Hendhelij [v.277H/890 e.s.]

Ebu Muhamed AbduRrahman bin Ebu Hatim ka thënë:

⁶⁵ Transmetuar nga edh-Dhehebi në *el-Uluww*, f.179 dhe i është atribuar el-Khellal.

⁶⁶ *El-Uluww*, f.174.

“E pyeta babën tim dhe Ebu Zur’eh rreth medhhebit/qëndrimit të pasuesve të Sunetit në *Usul ud-Din*/bazat e fesë si dhe cilët nga dijetarët nga të gjitha vendet kishin takuar dhe çka besonin ata. Të dy ata më thanë: ‘Kemi njohur dijetarë nga të gjitha vendet: nga Hixhazi, nga Iraku, nga Shami, nga Jemeni, dhe qëndrimi i tyre ishte ...’ pastaj ata përmendën disa çështje, derisa thanë: ‘Allahu është mbi Arshin e Tij, i veçuar nga krijesat e Tij, siç e ka përshkruar Ai vetveten në Librin e Tij dhe në gjuhën e të Dërguarit të Tij [salallahu alejhi ue selam], pa pyetur ‘si është kjo?’ Dija e Tij përfshin gjithçka:

« **Kurrjë s’është si Ai. Dhe Ai dëgjon gjithçka, sheh gjithçka** » [esh-Shura, 11]⁶⁷

Abdullah bin Muslim bin Kutejbeh ebu Muhamed ed-Dineuerij [v.276H/889 e.s.]

Ai ka thënë:

“Krejt popujt, arabë a joarabë, thonë: ‘Allahu është mbi qiejt ...’ Në hadith: ‘Një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut me një robëreshë joarabe, më qëllim që ta lironte. I Dërguari i Allahut [salallahu alejhi ue selam] e pyeti: ‘Ku është Allahu?’ Ajo u përgjigj: ‘Mbi qiejt’. I Dërguari [salallahu alejhi ue selam] tha: ‘Kush jam unë?’ Ajo u përgjigj: ‘Ti je i Dërguari i Allahut’. I Dërguari i Allahut tha: ‘Ajo është besimtare’. Pastaj urdhëroi që ajo të lirohej. Ky është hadithi apo ngjashëm me të”⁶⁸.

Imam *el-Al-lameh* el-Hafidh en-Nakid Uthman bin Se’id ed-Darimij [v.280H/893 e.s.]

Ai ka thënë:

“Muslimanët janë pajtuar rreth asaj se Allahu është mbi Arshin e Tij dhe mbi qiejt”⁶⁹.

Ai, po ashtu, ka thënë:

“Muslimanët si edhe mosbesimtarët janë pajtuar se vetëm Allahu është mbi qiejt, përveç të devijuarit el-Marisij dhe shoqëruesve të tij”⁷⁰.

Imami i Imamëve, Muhamed bin Is’hak bin Khuzejmeh [v.311H/923 e.s.]

⁶⁷ Transmetuar nga el-Lalika’i, vëll.1, f.176-177.

⁶⁸ Ibn Kutejbeh, *Te’uil Mukhtelif il-Hadith* [Beirut: *Dar ul-Kutub el-Ilmijeh*, 1405H, botimi i parë], f.252-253.

⁶⁹ *Er-Redd alel-Marisij*, vëll.1, f.340.

⁷⁰ *Ibid.*, vëll.1, f.228.

Ai ka thënë:

“Kaptina: Përmendja e shpjegimit se Allahu është mbi qiejt, siç na ka informuar Ai në Shpalljen e qartë dhe në gjuhën e peygamberit të Tij [salallahu alejhi ue selam] dhe siç është kuptuar në animin natyror të muslimanëve, qofshin ata dijetarët e tyre, të paditurit e tyre, të lirët e tyre, burrat e tyre, femrat e tyre, të moçmit a fëmijët e tyre. Krejt ata që i luten Allahut, i ngrijnë kokët e tyre drejt qiejve dhe i shtrijnë duart Allahut”⁷¹.

Imam ebu Bekr Muhamed bin el-Husejn el-Axhurrij esh-Shafi’i [v.360H/971 e.s.]

Ai ka thënë:

“Ajo drejt së cilës dijetarët shkojnë është: Allahu – lavdi i qoftë Atij – është mbi Arsh, mbi qiejt, dhe dija e Tij përfshin gjithçka ...

Deri ku thotë:

“Pra, nëse dikush thotë:Çfarë kuptimi kanë fjalët e Tij:

« S’ka bisedë private mes tre vetëve veçse Ai është i katërti prej tyre. Dhe s’bëhen pesë vetë veçse ai është i gjati prej tyre ... » [el-Muxhadileh, 7]

Atij duhet t’i thuhet: Dija e Tij i përfshin ata dhe dija e Tij përfshin gjithçka nga krijesat e Tij. Dhe Ai është mbi Arshin e Tij. Në këtë mënyrë dijetarët e kanë shpjeguar këtë; ajeti, nga fillimi e deri në fund, tregon për dijen”.

Pastaj Imami tha:

“Kaptina: Përmendja e Sunetit ku atij që kupton i tregohet se Allahu është mbi Arshin e Tij dhe mbi shtatë qiejt e Tij, dhe se dija e Tij përfshin gjithçka dhe kurrjë në qiej e në tokë s’është e fshehur prej Tij”⁷².

Ebu Abdullah Ubejdullah bin Muhamed el-Ukberij en-Hanbelij Ibn Battah [d.384H/994 e.s.]

Ai ka thënë:

⁷¹ Ibn Khuzejmeh, *et-Teuhid* [Beirut: *Dar ul-Kutub el-Ilmijeh*, 1412H, botues Muhamed Khalil Herras], f.110.

⁷² *Es-Shari’ah* [Botimi i parë, botues Mu’essiset er-Rejan], f.300.

“Muslimanët – nga sahabët, tabi’inët dhe të gjithë dijetarët besimtarë – janë pajtuar se Allahu – i bekuar qoftë – është mbi Arshin e Tij dhe mbi qiejt, i veçuar nga krijesat e Tij dhe dija e Tij përfshin krejt krijesat. Kjo as nuk mohohet e as nuk refuzohet, përveç nga ithtari i inkarnimit [*Hululijeh*]”.

Imam el-Mukri el-Muhaddith Ebu Umer Ahmed bin Muhamed et-Telemenkij [v.429H/1038 e.s.]

Ai ka thënë:

“Muslimanët nga pasuesit e Sunetit janë pajtuar se kuptimi i thënies së Allahut:

« **Dhe Ai është me ju, kudo që të jeni** » [el-Hadid, 4]

dhe e thënieve të ngjashme në Kuran, është: dija e Tij [është me ju] dhe se Allahu është mbi qiejt me qenien e Tij, i vendosur mbi Fronin e Tij, ashtu siç do Ai”.

Po ashtu, ai ka thënë:

“Pasuesit e Sunetit thonë lidhur me thënien e Allahut:

« **Më i mëshirshmi i vendosur mbi Fronin** » [Ta-Ha, 5]

se *istiua* e Allahut mbi Arshin e Tij është e vërtetë dhe jo metaforë apo alegori [*al-mexhaz*]”⁷³.

El-Hafidh ebu Nu’ejm Ahmed bin Abdillan el-Esbahanij [v.430H/1039 e.s.]

El-Hafidh ebu Nu’ejm ka thënë në librin e tij *Mehexhhet ul-Uathikijn ue Medrexhet ul-Uamikijn*:

“Muslimanët janë pajtuar se Allahu është mbi Fronin e Tij, i vendosur mbi të e jo që “e ka pushtuar atë” siç thonë Xhehmitë”⁷⁴.

Edh-Dhehebi ka thënë:

“El-Hafidh el-Kebir ebu Nu’ejm Ahmed bin Abdullah bin Ahmed el-Asbahani, verifikues i *Hiljet ul-Eulija*, ka thënë në librin e tij mbi akiden se: “Mënyra jonë është

⁷³ Referenca është përmendur më herët.

⁷⁴ Transmetuar nga Shejh ul-Islam ibn Tejmije në *Mexhmu el-Fetaua*, vëll.5, f.60.

mënyra e selefit që pasojnë Librin, Sunetin dhe *ixhmanë* e umetit. Dhe nga ajo çka ata besonin është se Allahu gjithmonë ka qenë i përsosur, me të gjitha cilësitë e Tij të përjetshme”.

Deri ku thotë:

“Ai [Ebu Nu’ejm] ka thënë: ‘Hadithet që vërtetojnë Arshin dhe vendosjen e Allahut mbi të janë thënë nga ata [selefi] dhe janë vërtetuar nga ata jo nëpërmjet *teklif* [të pyeturit si] e as nëpërmjet *temthil* [krahasimit të Allahut me krijesat]. Allahu është i veçuar nga krijesat dhe krijesat janë të veçuara prej Tij. Allahu s’është as i inkarnuar brenda krijesave e as i përzier në krijesat. Ai është i vendosur mbi Fronin e Tij, mbi qiejt, dhe jo në tokë”.

Edh-Dhehebi ka thënë:

“Këta Imamë kanë transmetuar *ixhma* mbi këtë çështje dhe krejt lavdia i takon Allahut. Ebu Nu’ejm ishte hafidh i padiskutueshëm i joarabëve gjatë kohës së tij, i cili kombinonte mes transmetimeve fisnike dhe dijes”⁷⁵.

Shejh el-Imam el-Hafidh ebu Nasr Ubejdullah bin Se’id es-Sixhzi **[v.444H/1052 e.s.]**

Ai ka thënë në librin el-Ibaneh:

“Imamët tonë, si Sufjan eth-Theuri, Malik bin Enes, Sufjan ibn Ujejneh, Hammad bin Selemeh, Abdullah bin el-Mubarek, Fudejl bin Ijjad, Ahmed bin Hanbel dhe Is’hak bin Ibrahim el-Hendhelij janë pajtuar se Allahu është mbi Fronin e Tij me qenien e Tij dhe dija e Tij është në çdo vend”⁷⁶.

Shejh ul-Islam el-Imam ebu Uthman Ismail bin AbduRrahman es-Sabunij **[v.449H]**

Ai ka thënë:

“Pasuesit e Hadithit besojnë dhe dëshmojnë se Allahu është mbi shtatë qiejt, mbi fronin e Tij, siç ka thënë në Librin e Tij”.

Deri ku thotë:

⁷⁵ *El-Uluww*, f.243.

⁷⁶ *Ibid.*, f.266.

“Dijetarët e umetit dhe Imamët e shquar të selefit - Allahu i mëshiroftë – nuk dallojnë rreth faktit se Allahu është mbi Fronin e Tij dhe Froni i Tij është mbi shtatë qiejt”⁷⁷.

El-Imam *el-Al-lameh* Hafidh ul-Magrib ebu Umer Jusuf bin Abdullah bin AbdulBerr el-Endelusij el-Kurtubij el-Maliki [v.463H/1071 e.s.]

Ai ka thënë:

“Brenda kësaj është dëshmia se Allahu është mbi qiejt, mbi Fronin, mbi shtatë qiejt, siç kanë thënë xhemati. Kjo është dëshmia e tyre kundër Mu’tezileve dhe Xhehmive, të cilët thonë se Allahu është gjithkund dhe jo mbi Fronin e Tij ...”⁷⁸, pastaj përmendi dëshmitë.

Ai ka thënë:

“Po ashtu, nga dëshmitë që tregojnë se Ai është mbi Arsh, mbi shtatë qiejt, është ajo se të gjithë monoteistët, qofshin ata arabë, qofshin joarabë, kur i godet ndonjë fatkeqësi, ata i drejtojnë fytyrat nga qielli dhe lypin ndihmën e Zotit të tyre”⁷⁹.

Ai ka thënë:

“Domethënia e këtij hadithi [dmth hadithit të robëreshës] është i qartë dhe i mjafton [si dëshmi] cilësdo të folme, meqë, kur ai tha: ‘Ku është Allahu?’, ajo u përgjigj: ‘Mbi qiejt [*fi sema*]’. Në këtë qëndrojnë ithtarët e së vërtetës lidhur me interpretimin e thënies së Allahut:

« **Më i mëshirshmi i vendosur mbi Fronin** » [Ta-Ha, 5]

Se, kur i godet ndonjë fatkeqësi muslimanët, çdo herë ata i ngritin duart dhe fytyrat drejt qiellit, duke shpresuar që Allahu t’u ndihmojë atyre”⁸⁰.

Imam el-Hafidh ebu Xhafer Muhamed bin ebi Ali el-Hasen el-Hemedhanij [v.531H/1137 e.s.]

Edh-Dhehebi ka thënë:

⁷⁷ *Akidet us-Selef ue As’hab ul-Hadith* [Kairo: *Dar ul-Menhexh*, 1423H, botimi i parë, botues Ebil-Jemin el-Mensurij], f.44.

⁷⁸ *Et-Temhid*, vëll.7, f.129-131.

⁷⁹ *Ibid.*, vëll.7, f.134.

⁸⁰ *Ibid.*, vëll.8, f.80.

“Muhamed bin Tahir ka thënë: Muhadithi ebu Xhafer el-Hemedhanij mori pjesë në një tubim ku Ebu Me’ali këshilloi e tha: ‘Allahu ishte atje edhe kur nuk kishte Arsh dhe tash është mbi atë që s’ishte aty?’ Ebu Xhafer tha: ‘Na informo, o profesor, lidhur me këtë domosdoshmëri që gjetëm [që ti po e përmend], sepse personi nuk thërret ‘o Allah’ veçse ndjen në zemrën e vet që kjo e bën të domosdoshme *el-uluww* [epërsinë] dhe ai nuk kthehet djathtas apo majtas. E, si atëherë mund ta mënjanojmë këtë domosdoshmëri [prirjen] nga vetët tona?’ apo tha: ‘A ka ilaç për shmangien e kësaj nevoje [prirjeje] që e ndjehmë?’ Ebu Me’ali tha: ‘O i dashuri im, s’ka gjë tjetër në këtë veçse hutim’. Atëherë, ai e goditi në kokë dhe ai ra poshtë e qau për një kohë, dhe pastaj tha: ‘el-Hemedhanij më hutoi’”⁸¹.

Imam el-Hafidh ebu’l-Kasim Isma’il bin Muhamed et-Tejmi et-Telhi el-Asbahanij [v.535H/1141 e.s.]

Ai ka thënë:

“Ata që e mohojnë epërsinë e Allahut mbi krijesat e Tij, pohojnë që s’është e lejueshme t’i drejtohem Allahut duke ngritur kokën apo gishtin, meqë, sipas tyre, kjo e bën të domosdoshëm pasjen e ‘kufirit’ dhe ‘mbylljes hapësinore’. Megjithëkëtë, muslimanët janë pajtuar se Allahu është më i larti i të lartëve dhe Kurani e thotë këtë:
« **Lartëso emrin e Zotit tënd, më të lartit ...** » [el-A’la, 1]

Ata pohojnë se kjo i referohet epërsisë së mposhtjes, jo epërsisë së qenies së Allahut. Megjithëkëtë, sipas muslimanëve, Allahu ka epërsinë e mposhtjes krahas krejt manifestimeve tjera të epërsisë, sepse epërsia [*uluww*] është përshkrim i lavdit. Allahu ka vërtetuar epërsinë e qenies së Tij si dhe të cilësive, dominimit dhe mposhtjes”.

Ebul-Uelid Muhamed bin Ebil-Kasim ibn Rushd el-Kurtubij [nipi] [v.605H/1209 e.s.]

Ai ka thënë në librin *Menahixh ul-Adileh fi-redd alel-Usulijin*:

“Thënia mbi drejtimin [*xhiheh*]: sa i përket këtij përshkrimi, atëherë njerëzit e Sheriatit nga gjeneratat e para e vërtetojnë këtë për Allahun, të fuqishmin e të madhërishmin. Mu’tezilet e mohojnë këtë dhe janë pasuar në këtë nga Esharitë e mëvonshëm si Ebul-Me’ali dhe kushdo që pasonte atë çka ai thoshte. Ajo që duket qartë në ligj, është se vërtetimi i drejtimit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm ...”

⁸¹ Shejh ul-Islam Ibn Tejmije e ka treguar këtë më zinxhirët e tij të transmetimit në *Nakd ut-Te’sis*, f.30. Po ashtu, i transmetuar nga edh-Dhehebi në *el-Uluww* [f.259] dhe *es-Sijer*, vëll.18, f.474.

Deri ku thotë:

“Krejt njerëzit e mençur janë pajtuar se Allahu dhe engjëjt janë në qiej, mu siç mbi këtë janë pajtuar të gjitha ligjet”⁸².

Imam Muwefekuddin ebu Muhamed Abdullah bin Ahmed bin Kudameh el-Makdisij [v.620H/1223 e.s.]

Ai ka thënë [në një stil të veçantë poetik]:

“Allahu e ka përshkruar veten me *el-uluww fi-semaa*
dhe qe përshkruar me këtë nga vula e *enbijaa*
dhe me këtë qenë pajtuar dijetarë nga sahabë e *fukahaa*.
Transmetime lidhur me këtë qenë përcjellë me *jekiin*
dhe këto u pranuar në zemrat e *muslimiin*.
Ky është besimi i natyrshëm për krijesa
kështu që, kur fatkeqësia i godet, ata shikojnë qiejt e ngritin duart duke bërë kërkesa.
Dhe ata presin ndihmën nga Krijuesi
duke e shprehur këtë me gjuhët e tyre.
Kjo nuk refuzohet nga dikush tjetër veçse nga ai që është zhytur në humbje
apo nga ai që është sprovuar nga pasimi i padiskutueshëm ndaj tij në shmangie”⁸³.

Ebu Abdullah Muhamed bin Ahmed el-Kurtubij [v.671H]

Ai ka thënë në *Sherh Esma ilahil-Husna* [Shpjegim i emrave të bukur të Allahut]:

“Ajo që është e qartë nga thëniet që janë transmetuar nga ajetet, nga tregimet, nga të ndriturit e nga njerëzit e drejtë është se Allahu është mbi Fronin e Tij ashtu siç ka informuar në Librin e Tij dhe në gjuhën e pejgamberit të Tij, pa pyetur si. Allahu është i veçuar nga krijesat e Tij. Ky është medhhebi/qëndrimi i selefus-salih siç e kanë përcjell transmetuesit e besueshëm prej tyre”⁸⁴.

Ai, gjithashtu, ka thënë:

⁸² Shejh ul-Islam ibn Tejmije e ka transmetuar këtë në *Dar et-Te'arud*, vëll.6, f.123 dhe në *Nakd ut-Te'sis*, f.97.

⁸³ Ibn Kudameh, *Ithbat Sifat ul-Uluww* [Kuwait: *Dar ibn ul-Ethir*, 1416H, botimi i dytë, botues Bedr el-Bedr], f.43.

⁸⁴ El-Kurtubi, *el-Esma fi Sherh Esma ilahil-Husna* [Tantaa, Egjipt: *Dar us-Sahabah*, 1416H, botimi i parë, botuar nga një panel hulumtuesish], vëll.2, f.132. Po ashtu, Shejh ul-Islam ibn Tejmije e ka transmetuar në *Dar et-Te'arud*, vëll.6, f.258; brenda *Bejaan Telbis ul-Xhehmije*, vëll.2, f.33; *Mexhmu el-Fetaua*, vëll.3, f.224; *Nakd ut-Te'sis*, f.106. Po ashtu, është transmetuar nga Ibn ul-Kajjim në *Ixhtima ul-Xhujsh el-Islamijeh*, f.263.

“Selefi – Allahu qoftë i kënaqur me ta – nuk thoshin gjë rreth ‘mohimit të drejtimit’. Ata s’kanë thënë gjë të kësaj natyre. Ata kanë pohuar çfarëdo që Allahu ka përmendur në Librin e Tij dhe çfarëdo që i Dërguari i Allahut informonte. Kurrkush nga selef us-salih nuk e refuzonte *istiua* e Allahut mbi Fronin e Tij në kuptimin e vërtetë, çka Allahu ka përmendur në veçanti, meqë ai [Arshi] është nga krijesat më madhështore të Tij. Bile, ata mohonin dijeni rreth mënyrës [*kefije*] të *istiua*, sepse realiteti i kësaj është i panjohur. Malik [rahimehullah] ka thënë: ‘*Istiua* është e njohur. Mënyra se si është kjo, është e panjohur. Hetimi rreth kësaj është bidat’. Kjo është çka Umm Selemeh [radi Allahu anha] gjithashtu ka thënë. Kjo mjafton dhe, kushdo që dëshiron të dijë më shumë rreth kësaj, le t’i referohet kësaj teme në librat e dijetarëve”⁸⁵.

Imam el-Hafidh Shemsudin Muhamed bin Ahmed bin Uthman edh-Dhehebij [v.748H/1347 e.s.]

Ai ka thënë:

“AbduRahman bin ebi Hatim er-Razij el-Hafidh ka thënë në librin e tij *er-Redd alel-Xhehmije*: ‘Babai im na ka informuar: Sulejman bin Harb na ka informuar: Kam dëgjuar Hammad bin Zejd të thotë: ‘Ata [Xhehmitë] gjithmonë shtyjnë opinionin se Allahu s’është mbi qiejt’.

Them⁸⁶: Thëniet e selefrit dhe të Imamëve të Sunetit, bile të Allahut e të Dërguarit të Tij si dhe të sahabëve e të besimtarëve janë se Allahu është mbi Arsh, mbi qiejt, dhe Ai zbret në qiejt e dunjasë. Dëshmitë e tyre për këtë janë tekstet dhe transmetimet. Sa i përket thënies së Xhehmive se Allahu është gjithkund, atëherë Allahu është i lartësuar nga kjo. Allahu është me ne me dijen e Tij. Sa i përket thënies së retorëve teologë që spekulojnë [*Mutekelimun*] se ‘Allahu s’është as në qiej, as mbi Arsh, as mbi qiej, as në tokë, as brenda botës, as jashtë botës, as i veçuar nga krijesat, as i lidhur me krijesat’ dhe thonë ‘Krejt këto nocione përdoren për të përshkruar trupa ndërsa Allahu është i lartë nga pasja e trupit’, pasuesit e Sunetit u kanë thënë atyre: ‘Ne nuk zhytemi në këtë. Ne themi atë që përmendëm në pasimin e teksteve. Ne nuk themi çka thoni ju, sepse kjo është mënyra për të përshkruar diçka që s’ekziston dhe Allahu është i lartë nga mosqenia. Ai ekziston i veçuar nga krijesat e Tij dhe Atë duhet përshkruar ashtu siç Ai e ka përshkruar vetveten – se Ai është mbi Fron -, pa u zhytur në mënyrën se si është kjo’⁸⁷.

Pastaj, duke transmetuar fjalët e el-Kurtubi, edh-Dhehebi tha:

⁸⁵ El-Kurtubij, *el-Xhami li-Ahkam il-Kuran* [Beirut: Dar ul-Kutub el-Ilmijeh, 1417H, botimi i pestë], vëll.7, f.140.

⁸⁶ Dmth. Edh-Dhehebi.

⁸⁷ *El-Uluww*, f.143.

“Gjithashtu, el-Kurtubi ka thënë në *el-Esnaa*: ‘Shumica e retorëve teologë të kohëve të hershme dhe atyre të mëvonshmëve thonë që është obligim të lartësohet Krijuesi [el-Barij] nga drejtimi dhe kufizimi hapësinor, kurse pasojë e domosdoshme e kësaj [sipas dijetarëve të tyre] është lartësimi i Allahut nga të qenët në një drejtim. Pra, sipas tyre, drejtimi s’është ‘lart’, sepse kjo do të kërkonte specifikimin e një drejtimi për Të, ku Ai do të ishte në një vend dhe në hapësirë të kufizuar. Prandaj, një vend dhe një kufizim do ta bënte të nevojshme lëvizjen, palëvizshmërinë, kufizimin hapësinor, transformimin [teghejjur] dhe ndodhitë e reja [huduuth]. [Pas kësaj, edh-Dhehebi thotë]: Kjo është thënie e *Mutekelimun* [retorëve teologë që spekulojnë].”

Edh-Dhehebi ka thënë:

“Po, kjo është në çka varen mohuesit e epërsisë së Allahut. Meqë ata shmangen nga ajo mbi çka bazohen Libri, Suneti, thëniet e selefëve si dhe prirja natyrore [*fitra*] dhe pohojnë se ajo çka ata përmendën, e bën të domosdoshme atë që u përshtatet trupave të njerëzve. Megjithatë, kurrë s’është e krahasueshme me Allahun. Qartësia e tekstit nënkupton të vërtetën, dhe ne nuk zbatojmë ndonjë shprehje veçse me një transmetim [që e vërteton atë].”

Pastaj, edh-Dhehebi thotë:

“Ne nuk pajtohemi që të qenët e Krijuesit mbi Fronin e Tij, mbi qiejt, e bën të domosdoshme që Ai të jetë i kufizuar në kuptimin hapësinor dhe që Ai të ketë një drejtim, meqë çfarëdo që është nën Fronin, mund të thuhet se është i kufizuar në kuptim hapësinor dhe ka drejtim, por ajo që është mbi të, s’është e këtillë. Allahu është mbi Fronin e Tij mu siç janë pajtuar gjeneratat e para dhe Imamët kanë transmetuar prej tyre. Në përgënjeshttrimin e Xhehmive, të cilët kanë thënë se Allahu është gjithkund dhe përdorën ajetin vijues si dëshmi të tyre:

« **Ai është me ju, kudo që të jeni** » [el-Hadid, 4]

ata kanë thënë se këto dy thënie qenë sajuar gjatë kohës së tabi’inëve dhe atyre që i pasuan ata. Dhe ka dy thënie në fjali që kanë kuptim.

Sa i përket thënies së tretë, të cilës i erdhi rendi më në fund, është ajo që thuhet se ‘Allahu s’është në një vend e as jashtë tij, as mbi Fronin e Tij, as i lidhur me krijesat e as i ndarë prej tyre. Qenia e Tij e shenjtë s’është as e kufizuar në kuptimin hapësinor e as e veçuar nga krijimi i Tij, e as që Ai është në ndonjë drejtim apo jashtë drejtimeve, as këtë e as atë ...’

Kjo është diçka që as nuk ka domethënie e as nuk mund të kuptohet! E të mos përmendim kundërshtimet ndaj ajeteve dhe transmetimeve që gjenden në këtë thënie. Pra, ikni me fenë tuaj dhe ruhuni nga pikëpamjet e retorëve teologë që spekulojnë.

Besoni në Allahun dhe në atë që ka ardhur nga Allahu në pajtim me qëllimin e Tij.
Dorëzohani çështjet tuaja Allahut. *La haula ue la kuwwete ila bilah!*